



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL  
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. \_\_\_\_prot. 2695

Tiranë, më 08.11.2024

VENDIM

Nr. 122, datë 08.11.2024

PËR

**DISA NDRYSHIME NË DIREKTIVAT E VLEFSHMËRISË AJRORE TË PRANUARA ME VENDIMIN NR. 88, DATË 29.07.2024 "PËR PRANIMIN DHE PUBLIKIMIN E DISA DIREKTIVAVE TË VLEFSHMËRISË AJRORE PËR ZBATIMIN E URDHRIT TË MINISTRIT NR. 79, DATË 15.04.2024"**

Në mbështetje të neni 14, pika (ë), të Ligj Nr.53/2022 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil" dhe në zbatim të pikës M.A.303, Pjesa M, Seksioni A, Nën pjesa C, e Urdhrit të Ministrit Nr.79, datë 15.04.2024, për miratimin e rregullores "Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionëve dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra".

V E N D O S A

1. Direktiva e vlefshmërisë ajrore ACAA-DFS-AD-No.013, pranuar dhe publikuar me Vendimin e Drejtorit Ekzekutiv nr. 88, datë 29.07.2024, ndryshohet dhe zëvendësohet me direktivën e vlefshmërisë ajrore si më poshtë:
  - me EASA AD No.: 2024-0097R2, ATA 53-Fuselage-Centre Fuselage/Main Landing Gear Door Keel Beam Hinge and Actuator Fittings-Inspection me kod ACAA-DFS-AD-No.013 Issue 01, Revision 01;
2. Direktivat e vlefshmërisë ajrore ACAA-DFS-AD-No.011 dhe ACAA-DFS-AD-No.012 shfuqizohen.
3. Ngarkohet Drejtoria e Standardeve të Fluturimit, në veçanti Sektori i Vlefshmërisë Ajrore, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria e Standardeve të Fluturimit të marrë masa për njoftimin apo publikimin për zbatim nga operatorët të Direktivave të mësipërme.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Aviacionit Civil.
6. Direktiva e ndryshuar ACAA-DFS-AD-No.013 i bashkëlidhet këtij vendimi.

**DREJTOR EKZEKUTIV**

**Maksim Et'hemaj**

